

FJALË PËRSHËNDETËSE

*Namik Dokle**

*I nderuar z. Guvernator,
Të nderuar pjesëmarrës,*

Kam kënaqësinë që në emër të Qeverisë Shqiptare të përshëndes punimet e kësaj konference.

Që nga synimi i saj për të analizuar rolin e bankave qendrore në periudhën e integritit, kuptoj se gjatë këtyre dy ditëve do të diskutohet gjerësisht për problemet aktuale dhe të perspektivës që karakterizojnë politikën monetare, mbikëqyrjen bankare, stabilitetin financiar jo vetëm në vendin tonë por edhe më gjerë, duke përfshirë edhe praktikatat e vendeve të ndryshme dhe eksperiencat e vendeve të Evropës Juglindore.

Duke parë programin, më vjen mirë që në punimet e kësaj konference marrin pjesë përfaqësues të nderuar nga vendi dhe bota, dhe jam i sigurtë se në referimet e tyre do të ketë konstatime interesante, të cilat do të përbëjnë dhe gjetjet kryesore të këtij aktiviteti.

Në filozofinë tonë qeverisëse gjithmonë e kemi konsideruar Bankën Qendrore si një partner të denjë, e cila me vendimet e saj luan një rol kyç jo vetëm në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomikë

të vendit, por edhe në sigurimin e stabilitetit financiar në përgjithësi. Po kështu, me kënaqësi konstatojmë se sistemi bankar sa vjen e po fuqizohet dhe ajo që është më e rëndësishmja, kemi një konsolidim gjithnjë e më të madh të tij.

Gjatë gjithë këtyre viteve kemi qenë të angazhuar në respektimin e pavarësisë institucionale të Bankës së Shqipërisë ashtu sikurse jemi përpjekur që politikat tona qeverisëse të mos kenë qenë në konflikt me politikat monetare të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se politikat fiskale të qeverisë hartohen në mënyrë të tillë që të jenë të harmonizuara me ato monetare, për aq kohë sa të dyja këto politika janë pjesë e programeve afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të vendit.

Po kështu, qeveria e ka konsideruar dhe e konsideron Bankën e Shqipërisë si një partnere të denjë edhe në fushën e këshillimit, dhe nga ky podium gjej rastin të falenderoj këtë institucion për mendimet e dhëna dhe rolin e saj aktiv në të gjitha tavolinat e debatit ku vendoset e ardhmja e vendimeve të politikave ekonomike.

Siç dihet, Shqipëria ka hyrë në një proces intensiv të negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit. Procesi i integritit evropian është konsideruar dhe konsiderohet si një prioritet madhor i Qeverisë Shqiptare. Realizimi me sukses i këtij procesi do të sjellë arritjen e standardeve evropiane në të gjitha fushat dhe mendoj se integrimi financiar është po aq i rëndësishëm dhe kompleks sa dhe integrimi politik, ai shoqëror dhe kulturor. Për këtë qëllim, ne jemi plotësisht të angazhuar edhe në përmbushjen e standardeve që lidhen me institucionet financiare, me tregjet, me drejtësinë, me gjykatat etj..

Në përfundim të kësaj përshëndetjeje të shkurtër, duke përfituar nga rasti më lejoni të falenderoj Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë z. Fullani për organizimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm, si dhe t'ju uroja punime të mbara dhe diskutime të frytshme, në emër të aspiratës sonë të integritit evropian të vendit.

Faleminderit!

* Namik Dokle: Zëvendëskryeministër i Republikës së Shqipërisë.